



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**KËSHILLI BASHKIAK BERAT**  
**Komisoni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale**

**RAPORT VENDIMMARRJE**

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë

**Lenda: “MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE  
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERËN FABIOLA  
SHENEPREMTE”**

**Analiza ligjore:** (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “, VKB-së nr.3, datë 30.01.2026 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe PBA përfundimtare 2026-2029”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”

**Situata aktuale e funksionit**(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

E ndjera znj.Fabiola Shenepremte, person i identifikuar në situatë rruge, pa banesë të qëndrueshme. Ajo njihej si e braktisur nga familjarët, të afërm dhe jetonte kryesisht me të vëllain e saj në rrugë, hapësira të hapura duke u përballur me kushte të vështira jetese dhe mungesë të plotësimit të nevojave bazike si higjena, kujdesi shëndetësor, strehimi.

Nga strukturat e shërbimit social, është vlerësuar situata e vështirë e jetesës që e ndjera ka pasur dhe pamundësia, pavarësia që asaj i mungonte për tu kujdesur për veten



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Duke u bazuar në historikun, problematikat e rastit dhe vlerësimin social nga strukturat e shërbimit social, pamundësive financiare për të përballuar shpenzimet e varrimit si person pa të afërm e cila nuk zotëron asnjë pasuri, kërkesës së paraqitur nga ***drejtori i Shërbimit Social***, propozon të përballoj shpenzimet e varrimit, në shumën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

### **Drejtoria / Sektori përgjegjës**

Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

### **A është objekt i konsultimit publik:**

Ky material nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**” , i mbledhur në datën 27/02/2026, shqyrtoi projekt vendimin “**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHKETJE FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERËN FABIOLA SHENEPREMTE**”

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

### **VENDOSI**

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në raste fatkeqësie, për të ndjerën Fabiola Shenepremte në shumën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.
2. Shuma prej 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2026.
3. Pagesa do të bëhet për llogari të subjektit që ka lëshuar faturën tatimore, i cili mundësojë shërbimin e varrimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale**

**Krenar Suku- Kryetar i Komisionit**

**Anisa Velu –N/Kryetar**

**Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit**

**Fatjon Elezi-Anëtar**

**Rovena Cuku-Anëtar**

**Muharem Hoxha-Anëtar**

**Shyqyri Dura-Anëtar**

Datë 27/02/2026